

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” është mbështetur në nenet 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon:

- a) krijimin e një mjeti efikas për realizimin e shkëmbimit automatik të informacionit, në zbatim të Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.178, datë 9.3.2016;
- b) garantimin e mbledhjes së informacionit të institucioneve financiare raportuese për raportimin e informacionit të caktuar financiar pranë autoritetit kompetent, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;
- c) përcaktimin e termave dhe kushteve të përgjithshme që lidhen me grumbullimin, përpunimin, përditësimin, bashkëveprimin, përqasjen, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit në lidhje me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare në çështjet tatimore;
- ç) detyrat dhe kompetencat e autoritetit kompetent për të siguruar zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me Standardin e Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë marrjen dhe përdorimin e informacionit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Që prej muajit nëntor të vitit 2012 Shqipëria është pjesë e Forumit Global mbi Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për Qëllime Tatimore (“*Global Forum on Transparency and Exchange of Information for Tax Purposes*”). Forumi Global është organizmi më i gjerë ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të informacionit për qëllime tatimore në luftën kundër evazionit fiskal, i mbështetur nga G20. Produkti më i rëndësishëm i Forumit Global është raporti i rishikimit (“*Peer Review*”). Raporti i rishikimit hartohet për çdo vend pjesëmarrës dhe përfshin vlerësimin e kujdesshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe praktikave të përdorura për shkëmbimin e informacionit tatimor në fushën e tatimeve. Pas vlerësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, Shqipëria është vlerësuar nga Forumi Global për fazën e dytë, e cila lidhet me zbatimin e standardeve në praktikë, ku është sugjeruar hartimi i akteve ligjore primare dhe sekondare për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit ndërmjet vendeve, të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen shumëpalëshe.

Rezultati kryesor i implementimit të Standardit të Përbashkët të Raportimit është angazhimi i vendeve anëtare në rritjen e transparencës në fushën e taksave, si vijon:

- a) Angazhimi i shumicës së vendeve anëtare të Forumit Global për të zbatuar standardet e reja për shkëmbimin automatik të informacionit deri në fund të vitit 2018, të shoqëruar me një shprehje të fortë mbështetjeje sidomos për vendet në zhvillim për të marrë pjesë në këtë ambient të ri transparence;
- b) Adaptimi, në parim, i termave të referencës mbi mënyrën e shkëmbimit automatik të informacionit;
- c) Mbështetja e madhe për vendet në zhvillim për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në shkëmbimin automatik të informacionit dhe lançimi i iniciativës afrikane.

Shqipëria, në datën 29 tetor 2014, ka nënshkruar marrëveshjen model shumëpalëshe të autoriteteve kompetente, në zbatim të nenit 6 “Shkëmbimi automatik i informacionit” të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellët në Çështjet Tatimore, të cilën Shqipëria e ka miratuar me ligjin nr.146/2013, datë 6.5.2013. Në zbatim të këtij neni të Konventës, nënshkrimi i marrëveshjes model shumëpalëshe të autoriteteve kompetente angazhon vendet nënshkruese për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit në fund të vitit 2017 ose në fund të vitit 2018.

Vendet nënshkruese ose ndryshe të quajtura grupi i adaptuesve të hershëm, duke ditur se evazoni tatimor mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në nivel

global, janë angazhuar nëpërmjet marrëveshjes për miratimin e një standardi të vetëm e të ri global, për shkëmbimin automatik të informacionit të tatimpaguesit dhe zbatimin e njëjtë dhe efektiv të këtij standardi.

Sipas standardit të ri global, një gamë e gjerë e informacionit do të shkëmbehet mbi llogaritë *offshore*, duke përfshirë bilancet e llogarive dhe të pronësisë. Kjo do të bëjë të mundur parandalimin e evazionit fiskal dhe trajtimin e mashtimit fiskal. Kjo pasi, veprimtaria e evazorëve jo vetëm zvogëlon të ardhurat publike, por dhe dobëson besimin në drejtësinë e sistemit tatimor, si dhe rrit barrën mbi tatimpaguesit e ndershëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar duke u mbështetur në nenin 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrimin e pjesshëm me *acquis* të BE-së, konkretisht direktivën 2011/16/EU mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve, të ndryshuar.

Përgatitja e projektligjit është bazuar në eksperiencat e zbatimit të CRS në vendet e rajonit si dhe në ato të vendeve të zhvilluara. Janë përshtatur një numër i konsiderueshëm elementesh dhe mekanizmash ligjorë të fushës së shkëmbimit automatik të informacionit nga vende në të cilat ky proces luan një rol prioritar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 5 krerë dhe 19 nene.

Kreu I përcakton qëllimin, objektin dhe fushën e veprimit të ligjit.

Neni 1 parashikon objektin e projektligjit që ka të bëjë me përcaktimin e rregullave në lidhje me shkëmbimin automatik të informacionit, detyrimin e institucioneve financiare raportuese për mbledhjen e raportimin e informacioneve të caktuara financiare pranë autoritetit kompetent, si dhe detyrat e kompetencat e autoritetit kompetent për të siguruar zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me Standardin e Përbashkët të Raportimit.

Nenin 2 parashikon qëllimin e projektligjit që synon të sigurojë zbatimin e dispozitave të Konventës për Ndihmën e Ndërsjelltë Administrative në çështje tatimore, si dhe marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

Neni 3 përcakton subjektet e këtij ligji që janë institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë që ngarkohen për raportimin e llogarive të raportueshme, të mbajtura nga personat e raportueshëm.

Në nenin 4 jepen përkufizime për termat kyç të përdorur në këtë projektligj.

Kreu II përcakton procedurat e raportimit e të verifikimit të duhur që qëndrojnë në themel të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare. Në këtë kre përcaktohen rregullat që u kërkojnë institucioneve financiare për të raportuar informacion në pajtim me qëllimin e raportimit dhe për të ndjekur procedurat e verifikimit të duhur në zbatim të Standartit të Përbashkët të Raportimit.

Neni 5 përmban kërkesën e përgjithshme të raportimit që zbatohet për institucionet financiare raportuese. Pikat 1 dhe 2 specifikojnë detyrimin e institucioneve financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë për t'i raportuar autoritetit kompetent informacionin mbi llogaritë e raportueshme vjetore brenda datës 30 maj të vitit vijues, si rregull i përgjithshëm, edhe në rastet kur nuk është identifikuar asnjë llogari e raportueshme, ndërsa pika 3 parashikon mënyrën e raportimit.

Në nenin 6 parashikohen procedurat e verifikimit të duhur që duhen kryer nga institucionet financiare raportuese për identifikimin e llogarive të raportueshme të përshkruara në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe mbledhjen e vetëdeklarimeve për llogaritë financiare të hapura deri më 1.1.2019 e në vijim.

Në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale institucionet financiare raportuese duhet të informojnë mbajtësit e llogarive se informacioni lidhur me llogaritë e tyre, nëse llogaritë e tyre janë llogari të raportueshme, do të raportohet dhe mund të shkëmbehet me juridiksione të tjera.

Në nenin 7 parashikohet siguria e të dhënave në momentin e ndarjes së informacionit brenda grupit të njëjtë ose me ofruesit e shërbimeve të palëve të treta. Projektligji lejon institucionet financiare raportuese që të përdorin ofrues shërbimesh për të përmbushur detyrimet e raportimit e të verifikimit të duhur të vendosura mbi këto institucione. Në këto raste, institucionet financiare

raportuese duhet të mbajnë përgjegjësi për detyrimet e tyre të raportimit dhe verifikimit të duhur (d.m.th. veprimet e ofruesve të shërbimeve i ngarkohen institucionit financiar raportues), duke përfshirë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave.

Kjo alternativë e lejon institucionin financiar raportues që të përdorë një ofrues shërbimesh i cili është rezident në të njëjtin juridiksion apo në një juridiksion të ndryshëm nga ai i institucionit financiar raportues. Gjithashtu, kjo nuk ndryshon kohën dhe mënyrën e detyrimeve të raportimit dhe verifikimit të duhur, të cilat mbeten njësoj sikur të ishin ende duke u përmbushur nga institucioni financiar raportues. Për shembull, ofruesi i shërbimeve duhet ta raportojë informacionin ashtu siç do të kishte bërë institucioni financiar raportues (p.sh. për të njëjtin juridiksion) dhe duhet të identifikojë institucionin financiar raportues për të cilin po përmbush detyrimet e raportimit dhe verifikimit të duhur.

Në nenin 8 parashikohen detyrat dhe kompetencat e autoritetit kompetent për të kërkuar dhe aksesuar informacionin e grumbulluar nga një institucion financiar raportues i Republikës së Shqipërisë në çdo kohë të arsyeshme.

Në nenin 9 përcaktohen rregullat të cilat u kërkojnë institucioneve financiare raportuese që të regjistrojnë hapat e ndërmarrë dhe çdo evidencë të përdorur për realizimin e procedurave të mësipërme dhe marrjen e masave të përshtatshme për regjistrimin e këtyre të dhënave. Në këtë nen sigurohet mbajtja e të dhënave dhe siguri i dokumentacioneve në lidhje me informacionin për procedurat e verifikimit të duhur që kërkohet të zbatohen me këtë ligj, të cilat janë hartuar për të identifikuar llogaritë raportuese të mbajtura nga institucione të tilla financiare.

Institucioni financiar raportues duhet të kujdeset për sa vijon:

- a) të mbajë regjistrimet që institucioni merr ose krijon me qëllim të përmbushjes së Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe këtyre rregullave dhe procedurave, duke përfshirë vetëcertifikimet, hapat e ndërmarrë për identifikimin e llogarive të raportueshme dhe të dëshmive të dokumentuara. Të dhëna të tilla duhet të mbahen ose në formë elektronike ose në letër;
- b) të mbajë ato të dhëna për një periudhë prej të paktën pesë vjet pas përfundimit të periudhës brenda së cilës institucioni duhet të raportojë informacionin e kërkuar për t'u raportuar sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit;
- c) të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të këtij ligji;

Në nenin 10 parashikohet detyrimi i autoritetit kompetent për të shkëmbyer informacionin mbi llogaritë e raportueshme, në pajtim me dispozitat e neneve 6 dhe 22 të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në çështjet tatimore, dhe në varësi të rregullave të raportimit dhe verifikimit të duhur në përputhje me Standardin të Përbashkët të Raportimit, çdo vit në mënyrë automatike me të tjerë autoritete kompetente, në lidhje me të cilat zbatohet marrëveshja, informacione këto të marra në bazë të këtyre rregullave dhe të specifikuara në rregulloren e zbatimit.

Kreu III përcakton se cilat janë shkeljet e kryera që konsiderohen kundërvajtje administrative, sanksionet/penalitetet që vendosen dhe procedura e apelit lidhur me moszbatimin në përputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura në këtë projektligj.

Neni 11 përcakton llojet e kundërvajtjeve administrative, referuar shkeljeve të kryera në kundërshtim me parashikimet e këtij projektligji.

Neni 12 parashikon sanksionet e vendosura, referuar kundërvajtjeve administrative të nenit 11.

Neni 13 parashikon të drejtën për apelim të subjekteve të këtij projektligji, referuar të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 14 përcakton rregullat për të parandaluar çdo institucion financiar, person ose ndërmjetës që të aprovojë praktika të cilat kanë për synim shmangien e procedurave të raportimit dhe verifikimit të duhur.

Kreu IV parashikon rregullat për konfidencialitetin dhe sigurimin e të dhënave. Ruajtja e konfidencialiteti të informacionit të tatimpaguesit ka qenë gjithmonë thelbësore në sistemin tatimor. Si tatimpaguesit dhe administratat tatimore kanë të drejtën ligjore të presin që informacioni i shkëmbyer të mbetet konfidencial. Me qëllim që të kenë besim në sistemet e tyre tatimore dhe të përmbushin detyrimet e tyre sipas ligjit, tatimpaguesit duhet të dinë se informacioni financiar, shpesh sensitiv, nuk i jepet palëve të tjera në mënyrë të papërshtatshme, as me qëllim dhe as aksidentalisht.

Në nenin 15 përcaktohen masat e duhura mbrojtëse për të garantuar konfidencialitetin e informacionit të marrë, i cili nënkupton që të dhënat ose informacioni nuk i jepet ose i vihet në dispozicion personave të paautorizuar.

Në nenin 16 garantohet siguria e të dhënave personale.

Kreu V i projektligjit parashikon dispozita të fundit që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 17 parashikon se dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij interpretohen në përputhje me Komentarin e Standardit të Përbashkët të Raportimit.

Neni 18 parashikon miratimin e akteve nënligjore me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji.

Neni 19 parashikon se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar me asistencën e ekspertëve nga administrata tatimore italiane (Agenzia delle Entrate), në kuadër të projektit për shkëmbimin automatik të informacionit, financuar nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si dhe asistencën e ekspertit nga OECD.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj pritet të ketë efekt në buxhetin e shtetit pasi për zbatimin e tij është i domosdoshëm implementimi i një sistemi të ri teknologjik, i cili ka një kosto prej rreth 45 000 000 lekësh për vënien në zbatim dhe në vitet në vijim një kosto prej rreth 15 000 000 lekësh në vit për mirëmbajtjen e sistemit teknologjik.

KËSHILLI I MINISTRAVE